

BASHKËFAJTORË NË MOSPUNË



*Analizë e punës së Këshillit Kombëtar
për Integrim Europian në Kosovë*



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Prishtina Office

Prishtinë, shtator 2013

BASHKËFAJTORË NË MOSPUNË



***Analizë e punës së Këshillit Kombëtar
për Integrim European në Kosovë***

E drejta autoriale © 2013. Fondacioni i Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Të gjitha të drejtat e rezervuara, përveç për citatet e shkurtra të parapara për qëllime të kritikës dhe recensionit. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem të ruajtjes apo të transmetohet në çfarëdo forme a mjete, qofshin ato elektronike, mekanike, fotokopjuese, të incizimit ose të tjera pa lejen paraprake të KCSF-së.

Përgatitur nga:

Mimika Loshi dhe Fatmir Curri

Ilustrimi në kopertinë: Jeton Mikullovc



Kjo analizë është hartuar në bazë të Memorandumit për bashkëpunim “Analiza e funksionimit dhe punës së strukturave të Kosovës për integrim në BE”, të nënshkruar mes Friedrich Ebert Stiftung (FES) Prishtinë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e KCSF-së, dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron qëndrimin apo pikëpamjet e FES-it apo të organizatave të saj simotra.

Bashkëfajtorë në mospunë

Përmbajtja:

Shkurtesat.....	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1. Hyrje	6
2. Pasqyrë e përgjithshme e qëllimeve dhe funksioneve të Këshillit	7
2.1 Krijimi i konczusit.....	8
2.2 Konsistenca dhe përmbajtja	11
2.3 Transparenca dhe komunikimi	14
3. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	16
Konkludimet dhe rekomandimet	18
Shtojca I –Metodologjia.....	20
Shtojca II – Lista e të intervistuarve	21
Shtojca III – Pyetëson	22
Lista e referencave:	23

Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BE	Bashkimi European
DPSA	Dialogu për Procesin e Stabilizim-Asocimit
FES	Friedrich Ebert Stiftung
IE	Integrime Europiane
IPA	Instrument për Asistencën e Para-anëtarësimit
KCSF	Fondacioni i Kosovar për Shoqëri Civile
KE	Komisioni European
KK	Kuvendi i Kosovës
KKIE	Këshilli Kombëtar për Integrim European
KPIE	Komisioni Parlamentar për Integrim European
MIE	Ministria e Integrimit European
MSA	Marrëveshje e Stabilizim Asocimit
OeK	Oda Ekonomike e Kosovës
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PSA	Procesi i Stabilizim-Asocimit
PVLV	Plani i Veprimit për Liberalizimin e Vizave
PVNMSA	Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet European
RrP	Rregullorja e Punës
TFIE	Task Forca për Integrim European
ZBEK	Zyra e Bashkimit European në Kosovë
ZK	Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje e përgjithshme

Këshilli Kombëtar për Integrim Europian është themeluar në vitin 2012 me qëllim të drejtimit të vendit në rrugën e reformave komplekse të cilat nevojiten për t'iu afruar BE-së. Megjithatë, edhe pas një viti të punës Këshilli nuk është duke e përmbushur misionin e vet.

Integrimet europiane gëzojnë përkrahjen e popullatës së Kosovës dhe në mënyrë retorike përkrahen edhe nga i tërë spektri politik i Kosovës. Përkundër kësaj, hulumtimi i KCSF-së ka ardhur në përfundim se Këshilli i themeluar për udhëheqjen e këtij procesi është i ndarë, i ndikuar nga politikat ditore, si dhe i menaxhuar në mënyrë të paefektshme e jotransparent në punën e tij. Këshilli nuk jep llogari për mangësitë e tij dhe funksionon kryesisht larg syve të qytetarëve.

Kjo analizë — e hartuar pas muajsh hulumtimi dhe intervistash me palët kryesore me interes — rezulton me rekomandime relativisht të lehta për tu zbatuar që synojnë transformimin e Këshillit nga një “vend i fjalëve të zbrazëta” në një organ kompetent, transparent dhe të efektshëm ashtu siç edhe është paraparë të jetë. Gjithashtu, në këtë dokument paraqiten edhe sugjerimet kryesore për organizatat e shoqërisë civile, mediet dhe institucionet e BE-së për të ndihmuar në realizimin e këtyre ndryshimeve.

Për më tepër, KCSF-ja thërret Këshillin që të përqendrohet në përcaktimin e drejtimeve strategjike dhe më pastaj në krijimin e koncenzusit rreth këtij vizioni. Po ashtu, insiston që të miratohet sistemi për monitorimin e punës së Këshillit në mënyrë që të shihet nëse është duke i zbatuar deklaratat dhe premtimet e veta. KCSF-ja gjithashtu kërkon që Këshilli ta respektojë rregulloren e vet të punës me rastin e caktimit të mbledhjeve, shpërndarjes së procesverbaleve dhe të përfundimeve, si dhe të komunikimit me publikun. Në këtë vazhdë, po kështu kërkohet që mbledhjet e Këshillit të jenë plotësisht të hapura për mediet në mënyrë që qytetarët e Kosovës të jenë të informuar për punën e Këshillit si dhe të kenë mundësi të kërkojnë llogaridhënje nga Këshilli.

Këshilli tanimë ka çuar poshtë vitin e tij të parë. Nëse mendon që ndonjëherë të luaj rol domethënës në çuarjen përpara të agjendës së integrimeve europiane të Kosovës, duhet të ndërmerri hapa të menjëhershëm në përmirësimin e punës së tij. Tani varet nga Qeveria, partitë opozitare, shoqëria civile dhe mediet që të ushtrojnë ndikim në Këshill për t'u ballafaquar me këtë sfidë.

1. Hyrje

Këshilli Kombëtar për Integrim European (më tutje në tekst – Këshilli) nuk i ka plotësuar pritjet gjatë vitit të parë të punës. Përkundër marrjes së përgjegjësisë për bashkimin e forcave politike në avancimin drejt integrimi evropiane—një synim shumë i popullarizuar në shoqërinë e Kosovës—Këshilli ka qenë i ndarë, ndërsa puna e tij ka qenë jotransparente dhe e paefektshme.

Hulumtimi dhe analiza e KCSF-së vjen në përfundim se Këshilli duhet të vazhdojë së ekzistuari vetëm dhe vetëm nëse ndërmerr masa serioze në përmirësimin e punës së vet. Nëse vazhdon së punuari siç ka bërë deri më tani, rrezikon të zbeh reformat dhe dinamikën e nevojshme, pasi që politikanët shfrytëzojnë Këshillin për “sfilatë politike.”¹

Në këtë dokument vihen në pah një sërë problemesh të Këshillit dhe propozohen mënyra për përmirësimin e funksionimit të tij. Përmes kësaj analize bëhen përpjekje në dhënien e përgjigjeve në tri çështjet vijuese:

- 1) A ka pasur sukses Këshilli në krijimin e koncenzusit mbarëkombëtar lidhur me agjendën e integritit evropian?
- 2) A ka pasur sukses Këshilli në arritjen e qëllimeve, për të cilat edhe është themeluar?
- 3) A ka qenë Këshilli transparent në komunikimin e tij me qytetarët?

Dhe në fund, në dokument gjithashtu shtjellohet aspekti nëse shoqëria civile ka qenë në gjendje të kontribuojë në mënyrë të efektshme në punën e Këshillit.

“Në këtë dokument tentohet të vihen në pah mangësitë e Këshillit në mënyrë që palët e interesuara të mund të përshtasin aktivitetet e mbikëqyrjes dhe avokimit me qëllim të përmirësimit të punës së përgjithshme të Këshillit.”

Ky dokument i drejtohet asaj audience që ka interes në procesin e integrimi evropiane të Kosovës, duke përfshirë edhe vet anëtarët e Këshillit, Qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës, Komisionin European, ekspertët e çështjeve të BE-së në Kosovë dhe organizatave të shoqërisë civile të interesuara në procesin e integritit të Kosovës në BE.

Njëkohësisht, KCSF-ja ka për qëllim që këto gjetje t’ua shpërndajë medieeve dhe qytetarëve në përgjithësi në mënyrë që të krijohet një platformë sa më e gjerë për të mbajtur Këshillin më përgjegjës dhe për t’i vënë nën presion palët përgjegjëse për mangësitë e tij.

Ky raport përmban një numër rekomandimesh të qarta për përmirësimin e funksionimit të Këshillit. Përmes këtyre rekomandimeve tentohet t’i ndihmohet Këshillit që të kthejë retorikën politike për integrimet evropiane në reforma të prekshme. Së këndejmi, tani është momenti i duhur që Këshilli të fillojë të luajë rol domethënës në këtë proces. Përndryshe duhet të japë përgjegjësi për dështimet e tij.

¹ Intervistë me Luan Shllaku, 26 korrik 2013

2. Pasqyrë e përgjithshme e qëllimeve dhe funksioneve të Këshillit

Këshilli për Integrim Europian i Kosovës është organi më i lartë politik bashkërendues në fushën e integritimeve europiane. I themeluar në mars të vitit 2012, ky Këshill kryesohet nga Presidentja e Kosovës, dhe përbëhet nga përfaqësuesit më të lartë të Qeverisë, të Kuvendit, të partive parlamentare, të gjyqësorit, të Asociacionit të Komunave, të shoqërisë civile, të sindikatave dhe të akademisë. Këshilli ka mandat për të siguruar rrugën e qartë dhe konsistente të Kosovës drejt integritimit në BE, pavarësisht ndryshimeve të mundshme në politikat partiake brenda Qeverisë dhe Kuvendit.

Sipas Rregullores së vet të punës², Këshilli duhet të takohet dy herë në vit për të dhënë udhëzime strategjike lidhur me procesin e integritimit europian. Deri më tani, Këshilli është takuar katër herë.³ Këshillit i është besuar bashkërendimi i qëndrimeve të institucioneve të shumta dhe rekomandimi i veprimeve për avancimin e procesit të integritimit europian. Më konkretisht, mandati i tij është si në vijim:

- Të përcaktojë orientimin strategjik të procesit të integritimit europian të Republikës së Kosovës;
- Të koordinojë dhe harmonizojë qëndrimet e institucioneve, partive politike dhe të shoqërisë civile në procesin e integritimit europian, me qëllim që të sigurojë përkrahjen e nevojshme institucionale politike dhe shoqërore për zbatimin e reformave të nevojshme;
- Të përcjellë progresin e Republikës së Kosovës drejt integritimit në Bashkimin Europian dhe
- Të japë rekomandime për procesin e integritimit europian përfshirë edhe për negociatat me Komisionin Europian dhe me shtetet anëtare të BE-së.

Në praktikë, një nga dështimet kryesore të Këshillit ka të bëjë me mungesën e fokusimit në përcaktimin e përgjithshëm strategjik të rrugës së Kosovës drejt BE-së. Këshilli i ka dhënë mandat Ministrisë së Integritimit Europian për të themeluar një Task Forcë për Integrim Europian (TFIE)⁴ me qëllim të hartimit të Strategjisë kombëtare për integrim europian.⁵ Kjo Strategji është pritur të diskutohet dhe miratohet nga Këshilli. Megjithatë, ky diskutim asnjëherë nuk është zhvilluar; në vend të kësaj Këshilli kryesisht u përqëndrua në temat e ditës, duke mos përcaktuar kështu asnjë orientim strategjik të perspektivës së Kosovës drejt BE-së.

² Rregullorja e punës, përmes së cilës themelohet Këshilli <http://www.president-ksgov.net/?page=1.129>

³ Shih tabelën 1.

⁴ Task Forca bashkëdrejtohet nga Vlora Çitaku, Ministre e Integritimeve Europiane, dhe Lutfi Haziri, shef i Komisionit parlamentar për integritime europiane. Diskutimet me pjesëmarrje të gjërë janë organizuar në kuadër të shtatë tryezave të rrumbullakëta tematike, të cilat pasqyruan ndarjen tematike të Dialogut të Procesit të stabilizim-asocimit. Objektivi i përgjithshëm i Task Forcë ishte hartimi i Strategjisë për integritime europiane të Kosovës, njëkohësisht duke zhvilluar më tej konzenzusun në mesin e palëve kryesore me interes dhe përcaktimin e rekomandimeve për Qeverinë e Kosovës.

⁵ Propozimstrategjia i është paraqitur Presidentes së Kosovës më 22 qershor 2013.

2.1 Krijimi i konkonzusit

Në Kosovë, politikat partiake dhe interesat politike trumbetojnë përkushtimin e përgjithshëm për t'iu afruar Bashkimit Europian. Përfaqësuesit e BE-së në veçanti do të kishin dëshirë që Këshilli të funksionojë në mënyrë të efektshme ashtu që aspiratat për BE-në të mbesin prioritet në agjendën politike. Për këtë arsye, përfaqësuesit e BE-së shpesh shfrytëzojnë Këshillin si forum për të përçuar porosinë që politikat ditore nuk duhet të gjejnë vend në procesin e integritimit europian. Në mënyrë që ky proces të jetë i qëndrueshëm, krijimi i konkonzusit rreth çështjeve të integritimit europian është i rëndësishëm jetike.

Krijimi i Këshillit, siç është rasti edhe me vendet e tjera të rajonit që kanë aspirata për BE⁶, është i paraparë të bëjë mu këtë, pra, të përcaktojë drejtimin strategjik të procesit të integritimit europian dhe të bashkërendojë e harmonizojë qëndrimet e institucioneve, partive politike dhe të shoqërisë civile në këtë proces me qëllim të sigurimit të përkrahjes institucionale të duhur për zbatimin e reformave të nevojshme politike e shoqërore. Këshilli pritet të jetë organi më i lartë politik që ndërton konkonzusin lidhur me agjendën e BE-së.

Kundërshtitë politike jashtë Këshillit kanë rezultuar me mospërfshirjen e të gjithë udhëheqësve opozitarë.

Në Kosovë ekziston konkonzus i gjerë politik e shoqëror lidhur me të ardhmen e Kosovës në BE. Megjithatë, ndasitë politike jashtë Këshillit kanë ndikuar në mundësinë e tij për t'i bashkuar të gjithë udhëheqësit opozitarë.⁷

Lëvizja opozitare Vetëvendosje gjithmonë ka deklaruar se përkrahë të ardhmen e Kosovës brenda BE-së, megjithatë e njëjta ka refuzuar të marrë pjesë në Këshill, duke argumentuar se themelimi i tij ka qenë i panevojshëm kur dihet mirëfilli se ekziston konkonzus i përgjithshëm shtetëror për procesin e integritimit europian, duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës. Vetëvendosja në përgjithësi ka qenë kundër krijimit të organeve dhe institucioneve të reja qeveritare. Kjo lëvizje mendon se institucionet ekzistuese duhet të punojnë më mirë dhe jo të krijohen institucione të reja. Për këtë arsye, udhëheqësi i Vetëvendosjes deri më tani ka refuzuar të merr pjesë në Këshill. Në mbledhjen inauguruese të Këshillit, mu për këtë arsye është ndryshuar edhe Rregullorja e punës. Ftesa është riformuluar për ta ftuar udhëheqësin e Vetëvendosjes në kapacitetin e tij të kryetarit të komisionit parlamentar për punë të jashtme dhe jo në atë të udhëheqësit të lëvizjes politike në Kuvend.⁸ Edhe pas këtij riformulimi, udhëheqësi i Vetëvendosjes asnjëherë nuk ka marrë pjesë, duke e zvogëluar kështu aftësinë e Këshillit për t'i bashkuar në mënyrë të suksesshme të gjitha partitë politike të Kosovës të përfaqësuara në Kuvend. Për më tepër, për shkak të kundërshtimeve politike brenda Zyrës së Presidentit, LDK-ja ka bojkotuar mbledhjen e parë të Këshillit, dhe i është bashkuar Këshillit vetëm pas mbledhjes së dytë.

⁶ Këta shembuj janë marrë prej Këshillave përkatës në Serbi, Mal të Zi, Kroaci dhe Maqedoni.

⁷ Jo të gjitha partitë opozitare janë përfaqësuar në Këshill. Këta udhëheqës opozitarë tanimë kanë një konkonzus në institucionet e tjera lidhur me temën e integritimit europian, gjegjësisht VV dhe LDK.

⁸ Drejtuesi i Komisionit për punë të jashtme është Albin Kurti, i cili njëherit është edhe udhëheqës i Vetëvendosjes.

Bashkëfajtorë në mospunë

Përkundër dyshimeve të disa partive opozitare, Qeveria deklaroi se krijimi i Këshillit ka qenë i nevojshëm dhe se nuk duplikon punën e Kuvendit apo të Qeverisë. Sipas mendimit të saj, Këshilli duhet të shërbejë si grup i 'njerëzve të urtë'⁹, ku pavarësisht se cila parti është në pushtet, agjenda europiane do të vazhdonte së zbatuari në nivelin më të lartë dhe se mangësitë në informata lidhur me reformat e BE-së dhe në mes të institucioneve e opinionit publik do të zvogëloheshin.

Nga ana tjetër, opozita është e bindur se krijimi i Këshillit është i padobishëm dhe i panevojshëm. Në këtë vazhdë, argumenton se koncenzi retorik për integritet europiane tanimë ekziston dhe se Këshilli nuk ka kompetenca ekzekutive për të kërkuar llogaridhënie edhe kur vet anëtarët e tij janë përgjegjës për reformat. Nëse institucionet përgjegjëse zbatojnë reformat, Kuvendi i Kosovës është institucion i mjaftueshëm për të siguruar llogaridhënie, duke e hequr kështu nevojën për ekzistimin e Këshillit. Safet Gerxhaliu, anëtar i Këshillit, madje shkoi më larg duke thënë se nëse një shtet ka për qëllim t'i ikë punës serioze dhe zgjidhjes së problemeve, atëherë ai themelon sindikata dhe këshilla".¹⁰

“Ekziston entuziazëm i madh për Bashkimin Europian, por nuk kuptohet sa duhet se çka në fakt përfshinë procesi i integriteteve europiane”

Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të mendimit se mospjesëmarrja pasqyron mungesën e efikasitetit të Këshillit. Po që se Këshilli do të funksiononte mirë dhe do të jepte rezultate, do të tërhiqte më shumë përkrahës dhe koncensus.¹¹ Opozita ngurron të bashkëpunojë në Këshill, duke u friguar se ky organ perceptohet se i shërben vetëm interesave të Qeverisë, kundruall pikëpamjeve të të gjitha shtresave politike dhe të shoqërisë lidhur me çështjet e BE-së.¹²

Duke marrë parasysh përbërjen e tij të tanishme, arritja e koncensusit brenda Këshillit është shumë e thjeshtë. Mungesa e diskutimeve thelbësore, të bazuara në informata e bën arritjen e pajtimit në vija të trasha për përkrahje të procesit të integritetit europian edhe më të lehtë.¹³ Në këtë kontekst, gjithmonë ekziston entuziazëm i madh për Bashkimin Europian, por kuptim jo i mjaftueshëm për atë se çka në fakt përfshinë procesi i integritetit.

Po ashtu, ekziston huti lidhur me rolin e Këshillit dhe pritjet nga ai. Përfaqësuesit e Qeverisë janë të mendimit se Këshilli duhet të paraqet udhëzimet në vija të trasha dhe të nxjerrë rekomandime, ndërsa partitë opozitare dhe anëtarët e shoqërisë civile argumentojnë se Këshilli duhet të jetë më aktiv në nxitjen e reformave specifike, duke kërkuar llogaridhënie dhe duke dhënë orientime të qarta strategjike në kuadër të procesit.

Këshilli duhet të caktojë drejtimet strategjike siç është përvoja në vendet e rajonit. Në Serbi dhe Maqedoni, për shembull, Këshilli përcjellë nga afër zbatimin e strategjive për anëtarësim në BE, si dhe propozon udhëzime konkrete për përmirësimin e procesit të përafrimit me BE-në. Në Serbi ky Këshill udhëhiqet nga Kryeministri/Qeveria, ndërsa në Maqedoni, Këshilli udhëhiqet nga Kuvendi. Kosova është i vetmi vend në rajon ku Këshilli udhëhiqet nga Presidentja. Zyrtarët

⁹ Intervistë me Besnik Vasollin, 4 qershor 2013.

¹⁰ Intervistë me Safet Gerxhaliu, 7 qershor 2013.

¹¹ Intervistë me Valdete Idrizin, 4 qershor 2013.

¹² Po aty.

¹³ Intervistë me Demush Shashën, 7 qershor 2013.

e Qeverisë deklaruan se roli i Presidentes në këtë rast është i logjikshëm, duke marrë parasysh se udhëheqësi i shtetit duhet të simbolizojë unitetin kombëtar në procesin e integrimi në BE.

Megjithatë, pozita e dobët politike e Presidentes pasqyrohet në mbarëvajtjen e punëve të Këshillit. Kështu, ky organ është shfrytëzuar për të përkrahur marketingun politik të Presidentes, ndërsa agjenda kryesisht udhëhiqet nga Qeveria. Shumica e të intervistuarve deklaruan se Këshilli është themeluar për rritur rëndësinë dhe performancën e Zyrës së Presidencës, si dhe të çojë përpara agjendën qeveritare të BE-së nën një titullar tjetër. Zyrtarët në Presidencë theksojnë se Presidentja është shumë aktive në promovimin e agjendës për integrim në BE të Kosovës.¹⁴

“Agjenda kryesisht udhëhiqet nga Qeveria.”

Këshilli nuk është dëshmuar të jetë gjithëpërfshirës apo i efektshëm. Kjo mundësi e humbur rezulton me mungesë të interesimit në mesin e anëtarëve për të marrë pjesë pasi që ata mendojnë se asgjë nuk mund të arrihet përmes Këshillit përveç shkëmbimeve rutinore të informatave. Ata besojnë se Këshilli nuk shërben për asgjë tjetër përveç se për fjalime politike, dhe thonë se organet e institucionet tjera mund të trajtojnë në mënyrë më të efektshme detyrat e Këshillit. Mimoza Gojani theksoi se, “Nëse shfrytëzohet në potencialin e tij të plotë,

“Puna e Këshillit ka rezultuar në fjalime politike.”

mund të jep kontribut domethënës në përpjekjet e Kosovës për integrim europian”.¹⁵ Megjithatë, Këshilli lehtë mund të bëhet i padobishëm nëse puna e tij zhvlerësohet dhe rezulton me deklarata boshe politike.

Në fund të fundit, të gjitha palët pajtohen se duhet të ndërmerren veprime me qëllim të përmirësimit të punës së Këshillit dhe të arritjes së pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse e të koncenzusit.

¹⁴ Intervistë me Adrian Prenkaj, 5 qershor 2013.

¹⁵ Intervistë me Mimoza Gojanin, 7 qershor 2013.

Bashkëfajtorë në mospunë

2.2 Konsistenca dhe përmbajtja

Mbledhjet e Këshillit Kombëtar nuk janë të përgatitura sa duhet dhe nuk kanë rende të ditës konsistente. Mbledhjet caktohen me paralajmërim të shkurtër dhe janë anuluar apo shtyrë disa herë, kanë mungesë të konsistencës, përgatiten dobët sa i përket përmbajtjes së tyre dhe kanë tendencë t'i shërbejnë politikës ditore. Të gjithë të intervistuarit—përveç punonjësve të sekretariatit të Këshillit¹⁶—u pajtuan se mbledhjet janë të përgatitura dobët, përmbajtja e thatë dhe mungesa e konsistencës ndikojnë negativisht në funksionimin e Këshillit.

Në vend të caktimit të prioriteteve strategjike, mbledhjet e Këshillit kanë tendencë të trajtojnë tema tjera që Qeveria i cakton si prioritete para çdo takimi. Përfaqësuesit e Qeverisë të intervistuar nga KCSF-ja deklaruan se kjo ishte një gjë e paevitueshme, pasi që shpesh u duhej të reagonin ndaj çështjeve kryesore që diskutoheshin brenda BE-së.

“Mbledhjet e Këshillit Kombëtar nuk janë të përgatitura sa duhet apo nuk kanë rende të ditës konsistente.”

Këshilli është paraparë të takohet dy herë në vit dhe të jep udhëzime strategjike për procesin e integritit evropian. Në vend të kësaj, ashtu siç është përshkruar në tabelën e mëposhtme, i njëjti u takua çdo katër muaj dhe ka trajtuar çështje ditore, duke reaguar ndaj nxitjeve dhe zhvillimeve politike.

Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian				
Nr. i takimit	Ftesat e dërguara	Data e takimit	Rendi i ditës	Procesverbali/përfundimete takimit
I.	22 mars 2013 (2 ditë pune paraprakisht)	27 mars 2012	Inaugurimi, Miratimi i RrP Paraqitja e strukturës së Studimit të Fizibilitetit	Nuk është në dispozicion Vetëm përfundimet janë vënë në web faqe
II.	22 qershor 2012 (5 ditë pune paraprakisht)	3 korrik 2012	Procesi i liberalizimit të vizave	Procesverbali është shpërndarë pas dy muajsh
III.	Është shtyrë dy herë Ftesa e fundit është dërguar një ditë para mbledhjes	12 dhjetor 2012	Studimi i Fizibilitetit për Kosovën	Draft procesverbali i mbledhjes është dërguar më 26 dhjetor 2012. Procesverbali përfundimtar nuk është dërguar fare
IV	13 mars 2013 (3 ditë pune paraprakisht)	19 mars 2013	Agjenda evropiane në përgjithësi – krijimi i koncenzusit	Draft procesverbali është dërguar më 26 prill 2013. Procesverbali përfundimtar nuk është dërguar fare

Tabela 1: Mbledhjet e Këshillit

¹⁶ Intervistë me Adrian Prenkaj, 5 qershor 2013.

Ftesat: Rregullorja e punës e Këshillit parasheh që mbledhjet e Këshillit të paralajmërohen së paku dhjetë ditë pune para mbajtjes së tyre. Në atë moment anëtarët e Këshillit duhet të ftohen për të propozuar pikat e rendit të ditës. Megjithatë, në realitet, mbledhjet janë paralajmëruar vetëm dy deri në pesë ditë përpara (shih tabelën 1). Në rastin e mbledhjes së tretë, për shkak të anulimeve dhe shtyrjeve, ftesa e fundit për anëtarët e shoqërisë civile erdhi vetëm një ditë para mbajtjes së mbledhjes. Kjo shkakton vështirësi për anëtarët që të përgatiten për mbledhjet e Këshillit, posaçërisht për ata që përfaqësojnë platforma më të mëdha. Për shembull, Valdete Idrizi merr pjesë në emër të Platformës Civikos¹⁷, e cila përfaqëson më shumë se 140 organizata. Për të njoftuar si duhet anëtarët e Platformës së saj dhe për të marrë komentet e tyre, ftesa është dashur të pranohet së paku dhjetë ditë pune para mbledhjes, ashtu siç parashihet në Rregulloren e punës të Këshillit. Nga intervistat po ashtu doli se shpërndarja e dokumenteve të Këshillit nuk ishte e njëtrajtshme: Përfaqësuesit e disa partive opozitare kanë pranuar ato me kohë ndërsa anëtarët e shoqërisë civile i kanë pranuar ato me një vonesë të konsiderueshme.¹⁸

Praktikat e lartpërkshkruara të punës, qofshin ato të qëllimshme apo jo, e zvogëlojnë motivimin e anëtarëve të Këshillit. Për më tepër, anëtarët nuk kanë kohë të mjaftueshme të përgatiten apo të propozojnë pika të rendit të ditës. Andaj, nuk është për t'u çuditur që mbledhjet e Këshillit nuk kanë substancë të duhur.

Mbledhjet e Këshillit poashtu caktohen për t'i plotësuar kërkesat e zyrtarëve të lartë të BE-së, gjegjësisht të Komisionarit të BE-së për fqinjësi dhe zgjerim, Shtefan Fyle. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, në mars të vitit 2013, komisionari Fyle kërkoi të jetë i pranishëm në mbledhjen e Këshillit për t'iu drejtuar të gjithëve lidhur me përparimin e Kosovës në agjendën e integritimit në BE.¹⁹ Për këtë arsye, mbledhja e katërt e Këshillit u ftua me nguti. Meqë njoftimi paraprak erdhi vetëm tri ditë para mbledhjes, përfaqësuesit e shoqërisë civile nuk morën pjesë.

Caktimi i rendit të ditës: Një praktikë tjetër e Këshillit është caktimi i rendit të ditës në bazë të çështjeve të politikës ditore lidhur me marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës. Prezantimi i Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave dhe i Studimit të Fizibilitetit të KE-së ka qenë pjesë e rendit të ditës gati në çdo mbledhje. Kjo qasje shkon në kundërshtim me misionin e Këshillit, që është dhënia e udhëzimeve konkrete për përmirësimin e procesit të përafrimit me BE-në, shqyrtimi i zotimeve nga mbledhjet paraprake dhe vlerësimi i zbatimit të tyre.

Përkundër kësaj, përmes këtij studimi kemi arritur në përfundim se nuk ekziston një vizion strategjik për procesin e integritimit në BE, të cilin do ta ofronte Këshilli. Për më tepër, në Këshill nuk ka ndërlidhje në mes zotimeve, gjegjësisht rekomandimeve të Këshillit dhe temave të rendit të tij të ditës. Për shembull, në mbledhjen e dytë të Këshillit, i njëjti kërkoi nga të gjitha institucionet përgjegjëse që të hartojnë plane veprimi lidhur me kushtet e paraqitura në udhëzuesin për liberalizimin e vizave. Këto plane nuk janë përgatitur apo prezantuar asnjëherë para anëtarëve të Këshillit për shqyrtim. Në vend të kësaj, në mbledhjen e tretë kjo është zëvendësuar me një temë tjetër – studimin e fizibilitetit të KE-së dhe kushtet e tij, të parapara për tu arritur brenda një afati të shkurtër. Në ndërkohë, Ministria e Integritimit European (MIE) ka

¹⁷ Për më shumë, vizito www.civikos.net

¹⁸ Intervistë me Burim Ramadanin, 20 qershor 2013 dhe Valdete Idrizin, 4 qershor 2013.

¹⁹ Intervistë me Adrian Prenkaj, 5 qershor 2013.

Bashkëfajtorë në mospunë

përgatitur Planin e veprimit për liberalizimin e vizave, por ky dokument asnjëherë nuk ka mbërri deri te Këshilli – qoftë për qëllime të dhënies së komenteve e as për ato të informimit.²⁰ Më vonë, ky dokument është vendosur në faqen e internetit të MIE-së.

Rekomandimet e Këshillit nga mbledhja e dytë, e mbajtur më 3 korrik 2012, parashihnin që autoritetet të fokusohen në kushtet e paraqitura në udhëzuesin për liberalizmin e vizave lidhur me rendin publik dhe sigurinë, gjegjësisht, me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Së dyti, aty rekomandohej edhe bashkërendimi i institucioneve në fushën e sundimit të ligjit me qëllim të zbatimit të masave përkatëse dhe buxhetimit të duhur. Në këto rekomandime parashihej që sundimi i ligjit të përkrahet me resurse të duhura administrative dhe njerëzore. Veprimet lidhur me këto rekomandime asnjëherë nuk janë realizuar. Kjo shkëputje e plotë mes mbledhjeve të Këshillit dhe rekomandimeve të tij i shndërron mbledhjet e Këshillit dhe konkluzionet nga to vetëm në një retorikë politike.

Procesverbalet dhe përfundimet e mbledhjeve: Një dobësi tjetër në mënyrën e funksionimit të Këshillit është mënyra e përpunimit të procesverbaleve dhe e përfundimeve. Siç është theksuar në tabelën 1, procesverbali nga mbledhja e parë asnjëherë nuk është bërë publik. Përfundimet nga kjo mbledhje janë vendosur në internet pasi që KCSF-ja, përmes anëtarit të vet, ka kërkuar që ato të bëhen publike. Procesverbali dhe përfundimet e mbledhjes së datës 3 korrik 2012 janë shpërndarë tek kah mesi i shtatorit – pas një vonese prej më shumë se dy muajsh! Këto vonesa i pamundësojnë secilit të përcjellë nëse përfundimet e Këshillit respektohen apo jo. Pas mbledhjes së tretë, përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë ngritur këtë çështje. Ata ia dërguan sekretarisë së Këshillit një letër zyrtare²¹, por efekti i saj ka qenë minimal. Pas mbledhjes së tretë dhe të katërt, përsëri është dashur të kalojnë pesë javë që Këshilli t’ia dërgojë procesverbalin anëtarëve të vet.

“Mangësitë teknike zvogëlojnë reputacionin e Këshillit, ndërsa mbledhjet e tij rezultojnë në jo më tepër se një mundësi për fotografim.”

Pas dërgimit të letrës së ankesës së shoqërisë civile në Këshill, sekretariati shpërndau draft procesverbalin, duke u ofruar mundësi anëtarëve që të japin komente. Së bashku me platformën CIVIKOS, KCSF-ja ka parashtruar komentet dhe ndryshimet në procesverbalin e mbledhjes së tretë, por asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë përgjigje zyrtare nëse sugjerimet e tyre janë marrë parasysh. Pas dy mbledhjeve të fundit, anëtarët kanë marrë vetëm draft procesverbalet dhe përfundimet. Në fakt, Këshilli Kombëtar asnjëherë nuk dërgoi procesverbalet dhe konkluzionet përfundimtare.²²

Disa anëtarë të Këshillit pajtohen se këto praktika joprofesionale zvogëlojnë reputacionin dhe kredibilitetin e Këshillit. Ata gjithashtu janë të bindur se mbledhjet janë pak më shumë se një mundësi për fotografim. Për ta mbështetur këtë deklaratë, ata theksojnë se pas daljes së medie, më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit po ashtu lëshojnë takimin. Si rrjedhojë,

²⁰ Intervistë me Burim Ramadanin, 20 qershor 2013.

²¹ Letra e dërguar Këshillit Kombëtar për Integritet Europian nga anëtarët e tij prej radhëve të shoqërisë civile, Fatmir Curri (KCSF) dhe Valdete Idrizi (CIVIKOS), e datës 17 dhjetor 2012.

²² Intervistë me Adrian Prenkaj, 5 qershor 2013.

temat e diskutimit trajtohen sipërfaqësisht, pasi që motivimi në Këshill bie sapa që anëtarët e tij dalin nga mbledhja.

Këshilli nuk ka mekanizma dhe struktura për përcjelljen e zbatimit të vendimeve të tij dhe për kërkimin e llogaridhënies. Për shembull, në mbledhjen e tij të parë Këshilli ka mandatuar Task Forcën për Integrim European që të përgatisë një raport diagnostifikues lidhur me Strategjinë kombëtare për integrim europian. Ishte paraparë që ky raport të diskutohej në mbledhjen e Këshillit në vjeshtën e vitit 2012. Megjithatë, raporti asnjëherë nuk është vendosur në tryezë për diskutim, e as që e kanë parë ndonjëherë anëtarët e Këshillit. Paradoksalisht, draft-versioni i kësaj Strategjie është shpërndarë në fund të qershorit 2013 së bashku me ftesën për mbledhjen e pestë. Kjo ftesë ka ardhur një ditë pune para mbledhjes.²³ Përveç se është dërguar 9 ditë me vonesë, ishte plotësisht e pamundur që anëtarët e Këshillit në këtë afat të shkurtë ta analizojnë Strategjinë e bashkëngjitur – një dokument ky voluminoz, ku mbuloheshin sektorë dhe tema të ndryshme. Kjo mbledhje është shtyrë për arsye të panjohura.

2.3 Transparenca dhe komunikimi

Këshilli Kombëtar për Integrim European nuk është transparent në veprimet e tij dhe nuk e informon në mënyrë të efektshme publikun e Kosovës. Ky argument gjen mbështetje në disa konsiderata, duke përfshirë: përbërjen dhe formatin e mbledhjeve, mungesën e konsultimeve në kohë të duhur dhe të procesverbaleve, mungesën e komunikatave për shtyp pas çdo mbledhjeje, informatat e pakta në faqen e internetit të Këshillit, mosbërjen publike të listës së anëtarëve të Këshillit dhe mungesën e informatave të kontaktit për vet sekretarinë e Këshillit.

“Këshilli Kombëtar për Integrim European ka mangësi në transparencë dhe komunikim me qytetarët e Kosovës.”

Përbërja e Këshillit dhe formati i mbledhjeve: Përbërja e Këshillit nuk mbulon tërë spektrin e shoqërisë së Kosovës. Në vendet e tjera të rajonit, siç janë Maqedonia dhe Serbia, forumet e ngjashme përfshijnë pjesëmarrës nga qarqet universitare, shoqatat e medie, sindikatat, udhëheqësit fetarë, si dhe personalitete të shquara, kontributi i të cilëve është i vlefshëm për procesin e anëtarësimit në BE. Në asnjë rast, Këshilli Kombëtar i vendeve fqinje nuk fton udhëheqësin e Zyrës së BE-së në mbledhjet e Këshillit Kombëtar, e as që i fton ambasadorët e tjerë të shteteve anëtare të BE-së apo të shteteve të tjera. Arsyeja për këtë është e thjeshtë: këshillat janë themeluar për të shërbyer si këshilla “kombëtare” për integrim europian. Udhëheqësi i Zyrës së Bashkimit European në Kosovë (ZBEK) sigurisht ka qëllime shumë të mira për dhënien e kontributit në këto mbledhje. Megjithatë, prania e tij duhet të zvogëlohet për t’u siguruar që Këshilli të mbetet institucion vendor që do t’i jep llogari të plotë akterëve vendorë.

Mbledhjet e Këshillit janë të ndara në dy pjesë: pjesa e parë është e hapur për medie, ndërsa pjesa e dytë është e mbyllur. Përfundimet e Këshillit vendosen në internet, ndërsa procesverbali u vihet në dispozicion vetëm anëtarëve. Rrjedhimisht, shumë çështje në interes të përgjithshëm të qytetarëve mbahen larg audiencës së gjerë. Disa zyrtarë qeveritarë theksojnë se hapja e pjesës së dytë të mbledhjes për medie do të ishte kundër-produktive pasi

²³ Këshilli i ka dërguar ftesat për mbledhjen e pestë më 20 qershor, (e enjte), të planifikuar të mbahet më 22 qershor 2012 (e shtunë).

Bashkëfajtorë në mospunë

që anëtarët do të ngurronin t'i shtjellonin haptazi para kamerave qëndrimet e tyre. Sa i përket kësaj, KCSF-ja mendon se hapja për publik e mbledhjeve të Këshillit do të rriste besimin e qytetarëve ndaj punës së Këshillit dhe do të rriste llogaridhënien e anëtarëve të tij.

Duke mos i përfshirë mediet në pjesën e dytë të mbledhjes Këshilli ka dështuar t'ua paraqes qytetarëve një pasqyrë të baraspeshuar, ku grupet e shoqërisë civile, sindikatat dhe palët e tjera jo-qeveritare kanë mundësi të japin mendimet e veta në tema të ndryshme (pjesa e parë e mbledhjes ka të bëjë vetëm me fjalimet dhe komentet e akterëve politikë). Një anëtar i Këshillit u ankua se “është e padobishme që gjithnjë të dëgjoen fjalimet e njëjta, ku vërtetohet vullneti politik për integrim europian. Ekziston nevojë e madhe për diskutimin e reformave, në fushën e sundimit të ligjit, cilësisë së ligjeve dhe zbatimin e tyre, si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik.”²⁴

Komunikimi me qytetarët nuk ekziston. Përveç transmetimit të pjesës së parë të mbledhjeve të Këshillit drejtpërdrejt në televizion dhe vendosjes në internet të fjalimeve të përgatitura të politikanëve, qytetarët nuk informohen për procedurat, aktivitetet dhe vendimet dhe punën e Këshillit. Dokumentet e Këshillit nuk u vihen në dispozicion qytetarëve e nganjëherë madje edhe vet anëtarëve të tij.²⁵ Sa i përket kësaj çështjeje, anëtari nga shoqëria civile thekson se

“Çështjet e interesit të përgjithshëm të qytetarëve janë mbajtur jashtë debatit publik dhe kanë qenë të mbyllura për mediet”.

madje edhe për të si “një përcjellës i përkushtuar i politikës dhe i çështjeve të integriteteve europiane, puna e Këshillit është e paqartë. Njeriu mund të paramendojë se sa një qytetar i rëndomtë mund të dijë për Këshillin”.²⁶ Një anëtar tjetër i Këshillit, Burim Ramadani nga AAK, deklaroi se “Ne kemi pritur shkëmbim të informatave për punën e Task Forcës për integritete europiane. Ne si parti opozitare që jemi, dëshirojmë që të njoftohemi lidhur me progresin e punës të Task Forcës. Ne dëshironim të kishim pasqyrën e gjendjes së tanishme dhe vendosjen e orientimeve strategjike. Asnjë nga këto nuk na është raportuar ne si anëtarë të Këshillit. Neve na është dashur që vet t'i gjejmë këto informata përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë edhe atë të Kuvendit të Kosovës”. Valdete Idrizi, përfaqësuesja e shoqërisë civile në Këshill, komentoi: “Nuk kam pritur të ndodhin çudira, por së paku kam pritur që Këshilli do t'i shpërndante dokumentet e tij dhe se do të jetë më i hapur ndaj anëtarëve të tij dhe qytetarëve në përgjithësi”.²⁷

Këshilli gjithashtu ka mungesë të kapaciteteve administrative për trajtimin e duhur të komunikimit me publikun. Për shembull:

Këshilli i bën publike vetëm përfundimet e tij, ndërsa procesverbalet e mbledhjeve nuk bëhen publike.²⁸ KCSF ka ndihmuar në hartimin e propozim-rregullores së parë të punës të Këshillit dhe ka propozuar që procesverbalet e mbledhjeve të jenë plotësisht në dispozicion për qytetarët. Kjo është një praktikë tek këshillat e ngjashëm në rajon. Fatkeqësisht, ky propozim nuk është marrë parasysh gjatë miratimit të Rregullores përfundimtare të punës. Publikimi i procesverbaleve do të rriste besimin tek qytetarët dhe do të përmirësonte llogaridhënien e

²⁴ Intervistë me Safet Gërxhaliun, 7 qershor 2013

²⁵ Intervistë me Burim Ramadani, 20 qershor 2013.

²⁶ Vrojtimit i fokus grupit me OShC-të, 19 qershor 2013.

²⁷ Intervistë me Valdete Idrizin, 4 qershor 2013.

²⁸ Neni 8.2 i Rregullores së punës mund të gjendet në <http://www.president-ksgov.net/?page=1,129>

anëtarëve të Këshillit. Përveç kësaj, kjo do të ishte një platformë e dobishme për shoqërinë civile për të përcjellë punën e Këshillit dhe për të krahasuar atë me vendimet që i merr.

Faqja e internetit e Këshillit nuk ofron informata për emrat e anëtarëve të tij dhe për informatat kontaktuese të tyre. Madje nuk paraqet as informatat kontaktuese për sekretarinë e tij.²⁹ Një situatë e çuditshme doli në pah kur mediet përgatiten një artikull/storje për Këshillin dhe bashkëpunimin e tij me shoqërinë civile, dhe asnjëri prej anëtarëve të Këshillit nuk u intervistuan. Për ta bërë punën edhe më keq, për këtë temë janë intervistuar njerëz që fare pak apo asgjë nuk kishin të bëjnë me Këshillin. Arsyetimi i medieve ishte se ato nuk dinin se kush ishte anëtar i Këshillit. Në fakt, faqja e internetit e Këshillit³⁰ nuk paraqet përgjegjësitë apo informatat kontaktuese për sekretarinë e tij³¹, duke e bërë kështu shumë të vështirë që dikush të kontaktojë atë për ndonjë informata. Ekzistimi i një Këshilli transparent është parakusht thelbësor për një proces të integritit evropian të hapur dhe të efektshëm.

3. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Shoqëria civile nuk ka dhënë kontributin maksimal në Këshill. Andaj, është me rëndësi të analizohet roli i shoqërisë civile dhe kontributi i saj në Këshill. Bashkëpunimi mes qeverisë dhe shoqërisë civile është i rëndësishëm në çuarjen përpara të agjendës së BE-së. Si i tillë, Këshilli duhet të lavdërohet për përfshirjen e shoqërisë civile në përbërjen e tij që nga fillimi i procesit. Kjo praktikë mund të shërbejë si standard për kultivimin e një bashkëpunimi të strukturuar mes shoqërisë civile dhe të qeverisë edhe në sferat e tjera.

Pjesëmarrja proaktive e shoqërisë civile në Këshill nuk është opcionale, por është domosdoshmëri nëse dëshirojmë të arrijmë drejt proceseve të BE-së që janë demokratike, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Pasi që shoqëria civile është anëtare përbërëse e Këshillit, duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive me qeverinë dhe me palët e tjera me interes. Rregullorja e punës e Këshillit është një instrument që ua mundëson përfaqësuesve të OShC-ve të jenë anëtarë të rregullt/të barabartë në Këshill. Rregullat nuk specifikojnë kufizime në numra të anëtarëve, edhe pse aktualisht Këshilli ka pesë anëtarë që përfaqësojnë shoqërinë civile.³²

“Shoqëria civile nuk ka dhënë kontributin e saj më të mirë në Këshill.”

Fillimisht, KCSF-ja ka përkrahur Këshillin në hartimin e Rregullores së punës, duke përfshirë dokumentet lidhur me pjesëmarrjen e shoqërisë civile në Këshill.³³ KCSF-ja ka rekomanduar që dy anëtarë të shoqërisë civile dhe dy nga mediet të bëhen anëtarë të Këshillit. Këta katër anëtarë do të mbulonin procesin e integritit evropian në përgjithësi, si dhe të kriterëve të Kopenhagës. Megjithatë, versioni përfundimtar i këtyre dispozitave nuk parasheh përfshirjen e medieve dhe nuk ka caktuar numrin e përfaqësuesve të OShC-ve.

²⁹ Vegëza (linku) <http://www.president-ksgov.net/?page=1.129> paraqet vetëm kategoritë e institucioneve.

³⁰ <http://www.president-ksgov.net/?page=1.129>

³¹ Që nga 18 shtatori 2013, informatat për kontakt ende nuk gjenden në faqen e internetit të Këshillit.

³² Anëtarët e rregullt janë përfaqësuesja e Platformës CIVIKOS, Valdete Idrizi – drejtoreshë ekzekutive dhe përfaqësuesi i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri Civile (KCSF), Fatmir Curri – drejtor i Programit për integritime europiane, ndërsa përfaqësuesi i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Luan Shllaku – drejtor ekzekutiv, asnjëherë nuk ka marrë pjesë. Këshilli po ashtu ka anëtarë nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)³² dhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK)³².

³³ KCSF ka përgatitur draftet e para për: Ftesën për emërimet, Kriteret e përzgjedhjes dhe Formularin e aplikimit.

Bashkëfajtorë në mospunë

“Nuk mund të pritët të kemi një Këshill të fuqishëm pa zërin e fuqishëm të shoqërisë civile në Këshill.”

Edhe pse OShC-të kanë marrë ftesën për emërimë të përfaqësuesve të tyre në Këshill, vetëm një numër i vogël aplikacionesh janë pranuar. Këshillit i është dashur ta rishpallë ftesën dhe të inkurajojë drejtpërsëdrejti përfaqësues të ndryshëm për t’iu bashkuar. Kur u pyetën se pse përfaqësuesit e OShC-ve nuk kanë kërkuar në mënyrë aktive që të anëtarësohen në Këshill, ata theksuan ndikimin e kufizuar që kanë trupa të tillë dhe legjitimitetin e perceptuar që do t’i jepej Qeverisë, duke marrë pjesë në këtë proces. Të tjerët nënvizuan se monitorojnë në mënyrë kritike punën e institucioneve në kuadër të procesit të BE-së, dhe se luajtja e një roli formal në këto trupa patjetër se do të kufizonte pavarësinë e tyre.³⁴

Të gjitha argumentet e lartpërmendura tregojnë një shoqëri civile thellësisht skeptike, e cila ka humbur besimin në mundësitë e veta për të sjellë ndryshime në orientimin strategjik të Kosovës. Nëse vazhdon ky trend për mospjesëmarrje, do të zvogëlohet mundësia e shoqërisë civile për t’u ankuar rreth punës së Këshillit, organeve dhe institucioneve të tjera, ku Qeveria e ka ftuar atë të marrë pjesë, por ku ajo ka refuzuar. Pjesëmarrja e shoqërisë civile duhet të konsiderohet si përgjegjësi serioze nga të gjithë anëtarët e këtij sektori.

Një shoqëri civile e përkushtuar dhe e fuqizuar mund të luaj rol të rëndësishëm për t’u siguruar që Këshilli t’i jetësojë parimet e BE-së në praktikë. Ajo në vetvete është komponent thelbësor i çdo demokracie. Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile janë aktive në arenën publike dhe angazhohen në nisma, përmes të cilave kultivohet pluralizmi dhe demokracia pjesëmarrëse.³⁵ Duhet të theksohet se BE-ja ka kritikuar rregullisht mungesën e përfshirjes së shoqërisë civile në planifikimin e politikave në Kosovë.³⁶ Kultura e përfshirjes dhe e bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe shoqërisë civile ka nevojë për përmirësime. Këshilli paraqet një strukturë të përshtatshme që kjo të ndodh. Andaj, as Këshilli e as shoqëria civile nuk duhet ta humbin këtë mundësi.

“Një shoqëri civile e fuqizuar mund të luajë rol të rëndësishëm për t’u siguruar që parimet e BE-së të jetësohen në praktikë.”

Nga ana tjetër, shoqëria civile nuk duhet të pranojë që përfshirja e saj në Këshill të jetë vet qëllimi. Shoqëria civile ka sfiduar Këshillin lidhur me përmirësimet e procedurave të tij, siç janë bie fjala, dërgimi i ftesave me kohë dhe shpërndarja e procesverbaleve dhe përfundimeve. Megjithatë, duhet gjithashtu të demonstrojë një qasje proaktive kur kemi të bëjmë me mungesën e substancës në mbledhjet e Këshillit. Përndryshe rrezikon që të bëhet edhe një bashkëfajtorë tjetër në punën dhe rezultatet e dobëta të Këshillit. Kjo duhet të ndryshojë menjëherë. Nuk mund të presim që të kemi Këshill të fuqishëm pa zërin e angazhuar të shoqërisë civile brenda Këshillit. Thënë troç, është lehtë të kritikosh dhe të ankoresh nga jashtë, por në momentin kur OShC-të bëhen jenë pjesë e mekanizmit formal, ato duhet të tregojnë përkushtim serioz në këtë drejtim.

³⁴ Vrojtim i grupit të fokusit me OShC-të, 19 qershor 2013.

³⁵ Udhëzimet për përkrahjen e shoqërisë civile nga BE-ja në vendet e zgjerimit, 2014-2020. DP e Zgjerimit.

³⁶ Raportet e progresit të KE-së 2009, 2010 dhe 2011.

Konkludimet dhe rekomandimet

Këshilli Kombëtar nuk ka arritë që t'i përfshijë në mesin e vet të gjithë liderët e opozitës. Mbledhjet e Këshillit nuk kanë përgatitje të mjaftueshme. Mbledhjet caktohen me paralajmërim të shkurtër, nuk kanë konsistencë, janë të dobëta për nga përmbajtja dhe kanë tendencë që t'u shërbejnë politikave ditore e jo vizionit strategjik. Shumica e këtyre janë mbajtur larg syve të qytetarëve duke qenë të mbyllura për mediet.

Këta faktorë e kanë ulur interesimin dhe entuziazmin e anëtarëve të Këshillit, shumica e të cilëve nuk janë të bindur se Këshilli mund ta përcaktojë drejtimin strategjik. Ky realitet nuk lë vend për kontribut, përfshirje dhe monitorim të procesit të integritit evropian nga ana e shoqërisë civile.

Këshilli duhet të krijojë konsensus dhe të jetë gjenerator i reformave. Ai duhet të përcaktojë prioritete dhe ta monitorojë zbatimin e masave për trajtimin e atyre prioriteteve. Mostrajtimi i problemeve të lartcekura do të na sjellë në situatë ku Këshilli mbetet forum për mbulimin e vonesave dhe për arsyetimin e mosveprimeve.

KCSF-ja do të vazhdojë monitorimin e punës së Këshillit për të përcjellë nga afër progresin në tejkalimin e dobësive dhe hapat që ndërmerren në atë drejtim. Në ndërkohë, për ta ndërprerë këtë cikël të padobisë dhe mosfunksionimit, KCSF-ja e ka përgatitur listën në vijim me rekomandime ndaj të cilave duhet të reagojnë të gjitha palët me interes.

Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian:

- Të caktojë drejtime strategjike për Kosovën në kuadër të agjendës për integrim evropian dhe të krijojë konsensus rreth atij vizioni.
- Të themelojë një sistem për monitorimin e punës së Këshillit, në veçanti kundrejt konkluzioneve/rekomandimeve të veta.
- Ta rishikojë Rregulloren e punës për t'i bërë takimet e Këshillit plotësisht publike përmes hapjes për medie të pjesës së dytë të mbledhjeve të Këshillit.
- Ta respektojë rregulloren e punës gjatë përgatitjes së takimeve, në veçanti lidhur me shpërndarjen me kohë të ftesave dhe rendit të ditës.
- T'i fuqizojë burimet administrative dhe njerëzore që merren me punën e Këshillit. Në veçanti, marrëdhëniet me publikun dhe komunikatat e Këshillit kanë nevojë të riorganizohen në mënyrë që kumtesat për shtyp dhe informatat e tjera të ndërlidhura të publikohen pas çdo mbledhjeje dhe që faqja e internetit e Këshillit mes të tjerash t'i përmbajë emrat, funksionet dhe informatat kontaktuese të të gjithë atyre që janë anëtar dhe që janë të ndërlidhur me Këshillin.

Qeverisë:

- Të përqendrohet në zbatimin e drejtimeve strategjike të caktuara nga Këshilli.
- Ta sjellë në diskutim dhe ta miratojë Strategjinë kombëtare për integrimin evropian si dokument strategjik kyç për udhëzimin e Kosovës në rrugën e saj për në BE.

Bashkëfajtorë në mospunë

- Ta trajtojë Këshillin si organ institucional më të lartë ku arrihen koncenzuse dhe krijohen qëndrime për mbështetjen e rrugës së Kosovës drejt integrimit në BE.
- T'i përgatisë dhe t'i ndajë bashkërisht raportet relevante me të gjithë anëtarët e Këshillit në mënyrë që të përmirësohet performanca e Këshillit.

Komisionit Europian/Zyrës së BE-së në Kosovë:

- Të merr pjesë në mënyrë më përzgjedhëse në mbledhjet e Këshillit. Përfaqësuesi i tyre nuk ka nevojë të merr pjesë në çdo takim të Këshillit. Roli i BE-së duhet të jetë mbështetës, por edhe kritik. Ky është Këshill Kombëtar e jo arenë për legjitimimin e çdo deklaratë të bërë prej eliteve politike në Kosovë.
- Ta monitorojë për së afërmi punën e Këshillit kundrejt zotimeve specifike që ai bën.
- Të avokojë që të gjitha takimet, procesverbalet dhe rekomandimet e Këshillit të bëhen plotësisht publike.

Partive në opozitë:

- Të veprojnë si opozitë konstruktive duke paraqitur pikëpamjet rreth mënyrës se si duhet të zhvillohet procesi për integrimin e vendit në BE.
- Të kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë në lidhje me reformat. Të kërkojnë që konkluzionet e Këshillit të shqyrtohen rregullisht për ta përcjellë progresin dhe që ata të cilët nuk ndërmarrin veprime sipas vendimeve të nxjerra nga Këshilli të japin llogari.
- Të ofrojnë alternativë konstruktive dhe të propozojnë zgjidhje për reformat kyçe që diskutohen.

Shoqërisë civile:

- Të nxitet në mënyrë proaktive Këshilli që ai të funksionojë sipas mandatit. T'i ofrohen Këshillit sugjerime dhe këshilla konstruktive për përmirësimin e punës së tij.
- T'i sjellen shqetësimet publike rreth procesit të integrimit europian dhe/apo rreth funksionimit të Këshillit në vëmendjen e tërë anëtarësisë së Këshillit. Të konsultohen dhe merren kontribute prej një spektri të gjerë të organizatave të shoqërisë civile.
- Të punohet për të siguruar që diskutimet e Këshillit të jenë substanciale dhe që të arrihet koncensus për reforma. Të shfrytëzohen mediet për t'i transmetuar zhvillimet në agjendën për BE-në me qëllim të informimit të qytetarëve.

Medieve:

- Të kërkohet qasje në takimet dhe përfundimet e Këshillit dhe të pasuara me raportim – në veçanti me ato të llojit që u vënë presion zyrtarëve për të dhenë llogari lidhur me premtimet dhe përgjegjësitë e veta.
- Të analizohen dokumentet kyçe lidhur me agjendën për BE-në për t'u pajisur me informacion rreth mbledhjeve të Këshillit dhe procedurave të tij.
- Të kontaktohen anëtarët e Këshillit për kontribute dhe mendime para raportimit në medie rreth punës së Këshillit.
- Të mbahen qytetarët në hap me zhvillimet – pozitive dhe negative – lidhur me procesin e integrimit në BE për ta nxitur mbështetjen e përgjithshme për fazat e ardhshme të reformave.

SHTOJCAT

Shtojca I –Metodologjia

Ky studim është hartuar përmes:

- 1) Hulumtimit të dokumenteve, me fokus të posaçëm në dokumentet e prodhuara nga vet Këshilli, që janë Rregullorja e punës, përbërja, ftesat, rendet e ditës, procesverbalet e takimeve dhe konkludimet/rekomandimet.³⁷
- 2) Intervistave cilësore, gjysmë të strukturuar me anëtarët e Këshillit dhe palët kyçe me interes (që përfaqësojnë Qeverinë, ambasadat e BE-së, partitë opozitare, Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit European në Kosovë, komunat, sindikatat dhe shoqërië civile). Shihni shtojcën II për listën e plotë të të intervistuarve.
- 3) Seancave të fokus grupit, të organizuara me përfaqësuesit e shoqërisë civile për shqyrtimin e vlerësimit të tyre rreth punës së Këshillit dhe për ta kuptuar më mirë raportin mes Këshillit dhe grupeve qytetare. Fokus grupet gjithashtu janë përdorur për ta vlerësuar dhe konfirmuar vlefshmërinë e të gjeturave kryesore nga intervistat.

³⁷ Këtu janë përdorur dy termet “konkludime” dhe “rekomandime” për shkak se sekretariati i Këshillit fillimisht i ka quajtur ato ‘konkludime’. Pas takimit të dytë të Këshillit, ato filluan të quhen si ‘propozime’ dhe në takimin e tretë të këshillit ato u quajtur ‘propozimrekomandime’.

Bashkëfajtorë në mospunë

Shtojca II – Lista e të intervistuarve

Nr.	Emri dhe mbiemri	Organizata/Pozita	Data
1	Sazan Ibrahim	Anëtar i KKIE Asociacioni i Komunave të Kosovës Drejtor Ekzekutiv	27 maj 2013
2	Besnik Vasolli	Koordinator i Projektit, GIZ	4 qershor 2013
3	Valdete Idrizi	Anëtare e KKIE Platforma CIVIKOS, Drejtoreshë Ekzekutive	4 qershor 2013
4	Alma Lama	Kuvendi i Kosovës, anëtare e Komisionit për integrimin europian, Deputete e Pavarur	4 qershor 2013
5	Adrian Prenkaj	Zyra e Presidentes së Kosovës, Këshilltar i presidentes, sekretariati i KKIE	5 qershor 2013
6	Lutfi Haziri	Anëtar i KKIE Kuvendi i Kosovës, kryesuesi i KPIE, LDK	6 qershor 2013
7	Mimoza Gojani	Ambasada e Mbretërsisë së Bashkuar, zyrtare për BE	7 qershor 2013
8	Safet Gërxhaliu	Anëtar i KKIE Oda Ekonomike e Kosovës	7 qershor 2013
9	Demush Shasha	Ministria e Integritit Europian, Sekretar i përgjithshëm	7 qershor 2013
10	Patrick SCHMELZER	Zyra e BE-së në Kosovë, zyrtar për politika	19 qershor 2013
11	Burim Ramadani	Anëtar i KKIE Kuvendi i Kosovës, AAK	20 qershor 2013
12	Luan Shllaku	Anëtar i KKIE KFOS, Drejtor Ekzekutiv	26 korrik 2013
13 - 16	Fokus grupi 1. Driton Selmanaj, KDI 2. Shpend Emini, D4D 3. Fisnik Korenica, GLPS 4. Albana Merja, GLPS	Përfaqësuesit e OSHC-ve	19 qershor 2013

Shtojca III – Pyetësi

Pyetjet kryesore:

- 1) Cilat janë pritjet nga KKIE?
- 2) A mendoni se ka koncenzus kombëtar brenda KKIE dhe si mundet Këshilli në të ardhmen të shtyjë përpara agjendën europiane?
- 3) Sipas opinionit tuaj, a ka qenë i nevojshëm themelimi i KKIE-së?
- 4) Sa ka arritur Këshilli të komunikojë me publikun?
- 5) Sa ka qenë transparent brenda me anëtarët dhe hisedarët tjerë?
- 6) A mendoni se puna e Këshillit ka
 - a. përmbajtje,
 - b. konsistencë,
 - c. përmbushje të angazhimeve të marra dhe
 - d. respektim të konkluzioneve/rekomandimeve të veta?

A. Rregullorja e punës dhe themelimi

- 1) A keni njohuri për ndonjë praktikë të ngjashme nga rajoni? A janë marrë parasysh praktikat më të mira të rajonit dhe nëse po, cilat?
- 2) A ka pasur nevojë që të themelohet një njësi/sekretariat i veçantë në Presidencë për KKIE? A ka pasur nevojë të themelohen njësi të reja në institucionet tjera për të zbatuar detyrat nga KKIE?
- 3) A ka kapacitet të mjaftueshëm administrativ brenda KKIE-së për të trajtuar ngarkesat e punës të dala nga mbledhjet? Cili është kualifikimi i stafit?
- 4) Kush e cakton agjendën e mbledhjeve të KKIE?
- 5) A ka staf adekuat për të kryer punët e komunikimit?
- 6) A ka staf të deleguar nga MIE/ ministritë përkatëse për të asistuar punën e KKIE?

B. Funkcionimi dhe performanca e KKIE

- 1) A është arritur koncenzusi në Këshill si për nga anëtarësia, përmbajtja dhe qëndrimet për të arritur tek një agjendë e përbashkët kombëtare për IE? Nëse jo, pse?
- 2) A jeni të kënaqur me Rregulloren e punës së KKIE-së? Nëse jo, pse?
- 3) A zbatohet në praktikë Rregullorja e Punës (ReP)? Më konkretisht, a zbatohen nenet si përbërja, thirrja e takimeve, përgatitja, procesverbalet, procesverbalet e mbledhjeve, rekomandimet e Këshillit?
- 4) A jeni konsultuar në hartimin dhe përgatitjen e mbledhjeve të ardhshme të Këshillit / agjendës?
- 5) A dërgohen paraprakisht materialet dhe raportet tek anëtarët? Sa kohë para mbledhjes i merrni agjendat, ftesat dhe materialet?
- 6) A raportohet për zbatimin e angazhimeve të marra/rekomandimeve nga mbledhjet e kaluara?
- 7) A ka ndërlidhje mes rekomandimeve nga mbledhja e kaluar dhe agjendës për mbledhjen e radhës?
- 8) A u shpërndahen anëtarëve dokumentet që qarkullojnë në Këshill? A janë mbledhjet e KKIE-së të hapura për mediet? A janë dokumentet zyrtare të KKIE-së të hapura për publikun?

C. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

- 1) Cili duhet të jetë roli i OShC-ve në këtë proces dhe veçanërisht në këtë Këshill?
- 2) A ka proces të konsultimit dhe përfshirjes së OShC-ve në punën e KKIE-së? A jeni të kënaqur me përfshirjen, përfaqësimin dhe kontributin e anëtarëve nga shoqëria civile?
- 3) A bëhen publike shqetësimet dhe pozicioni i përfaqësuesve të OShC-ve?
- 4) A merren parasysh rekomandimet dhe çështjet e shtruara nga përfaqësuesit e OShC-ve për mbledhjet e ardhshme të KKIE-së?

Lista e referencave:

1. Ftesat dhe rendet e ditës nga mbledhjet e Këshillit
2. Plani i veprimit për negocimin e MSA-së, 2012
3. Plani i veprimit për zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, Republika e Kosovës, 2013
4. Procesverbalet e mbledhjeve dhe konkludimet e Këshillit
5. Raporti i përbashkët i Parlamentit Europian dhe të Këshillit ndaj progresit të Kosovës për trajtimin e çështjeve të përcaktuara në konkludimet e Këshillit, i dhjetorit 2012, nga pikëpamja e një vendimi të mundshëm për hapjen e negociatave rreth MSA-së, 2013
6. Raporti i Progresit i KE 2009
7. Raporti i Progresit i KE 2010
8. Raporti i Progresit i KE 2011
9. Raporti prej Komisionit për Parlamentin Europian dhe Këshillin rreth progresit të Kosovës në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, 2013
10. Rregullorja e punës për themelimin e Këshillit Kombëtar për Integrim Europian
11. Strategjia Kombëtare për Integrimin Europian: Kosova 2020 një qasje gjithëpërfshirëse
12. Studimi i fizibilitetit, i kryer nga KE për Kosovën 2012
13. Udhëzimet për mbështetjen e BE-së dhënë shoqërisë civile në shtetet e zgjerimit, 2014 - 2020. DP për zgjerim